



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr 860 prot

Elbasan më 18.02.2025

RELACION

Mbi miratimin e kritereve të dhënies së Ndhmës Ekonomike nga fondi i Bashkisë

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar këshilltarë !

Drejtoria e Shërbimeve Sociale duke u bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”; në pikën 3 të kreut IV të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike” propozon miratimin e kritereve që duhet të plotësojnë familjet në mënyrë të tillë që të bëhen pjesë e trajtimit me ndihmë ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë.

Bazuar dhe në aktet e mësipërme familjet që do të trajtohen nga ky fond mund të jenë nga familjet aplikante në sistemin elektronik dhe që nuk janë shpallur fituese nga formula e pikëzimit.

Gjithashtu nisur nga përvoja dhe situata faktike ka disa familje të cilat janë shumë në nevojë ekonomike por për shkaqe të ndryshme nuk arrijnë të plotësojnë kushtet për aplikim në regjistrin kombëtar elektronik të ndihmës ekonomike.

Pikërisht këto familje propozojmë të trajtohen nga ky fond i cili është shumë i rëndësishëm për ti ndihmuar sadopak .

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj për miratim !

Konceptoi: M.Duka

Pranoi: D.Shuli

Konfirmoi: D.Rroseni

Zv.KRYETARI

Armand Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. _____ prot

Elbasan më _____ 2025

PROJEKT - VENDIM

Nr. ____ datë ____/02/2025

Mbi miratimin e kritereve të dhënies së Ndhmës Ekonomike nga fondi i Bashkisë

KËSHILLIT BASHKIAK

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/02/2024 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale , bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” në pikën 3 të kreut IV të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike”

VENDOSI

- I. Të miratojë kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i bashkisë si më poshtë:
 1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit .
 2. Familje shumë të varfëra që për shkaqe të ndryshme shëndetësore , sociale dhe familjare nuk arrijnë të aplikojnë në sistemin e ndihmës ekonomike sipas VKM nr. 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike”
 3. Familje të varfëra me një bashkëshort të larguar(apo në burg) dhe që nuk mund të fillojnë procedurat e divorcit, apo nuk sigurojnë dokumentat përkatës.
 4. Familje me probleme të tjera sociale.

- II. Dokumentat e aplikuesve të janë : Çertifikate familjare, fotokopje e kartës së identitetit , formulari i paraqitjes mujore , raporti (formulari) i përshkrimit të gjendjes social-ekonomike të familjes nga Administratori Shoqëror , dokument i statusit si punëkërkuës i

papunë nga AKPA ,dokument pronësie si dhe dokumente të tjera plotësuese për dosjen e familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë.

- III. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM nr 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike”
- IV. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale si dhe Drejtoria e Financës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Dr. i Shërbimeve Sociale D .Shuli
Drejtori Juridik A.Hoxha



Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja



Sekretari Këshillit Bashkiak

Kryetari I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



863
18.2.25



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr.Prot 863

Elbasan më 18/02/2025

RELACION

**Mbi dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin JANAR 2025
KËSHILLIT BASHKIAK**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 12 datë 23.02.2024 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”, paraqesim për miratim propozimin e familjeve që do trajtohen nga fondi i kushtëzuar.

**I. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin JANAR 2025 ,
246 familje me një fond prej 1.008.324 lekë.**

Këto janë familje të varfra të cilat kanë aplikuar në sistemin e ndihmës ekonomike dhe për shkak se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme, nuk janë kualifikuar përfitues të ndihmës ekonomike nga sistemi i pikëzimit.

Këto janë kryesisht familje me një ose dy antarë. Pra këtu kemi familje të cilat janë me një anëtarë, si femrat ose meshkujt në moshë të madhe të pamartuar ose të divorcuar, të cilët kanë ose jo një ose dy fëmijë në ngarkim ; personat mbi moshë pune të cilët nuk kanë përfituar pension pleqërie .

Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.

P/Konceptoi: M.Duka

Pranoi: D.Shuli

ZV/KRYETARI
ARMAND SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr _____ Prot

Elbasan më ____/02/ 2025

PROJEKT – VENDIM

Nr. ____ datë ____/02/2025

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin JANAR 2025

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____01/2025 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DPPSSSHKI, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 12 datë 23.02.2024 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin JANAR 2025 për 246 familje me një fond prej **1.008.324** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtor i Shërbimeve Sociale D.Shuli
Drejtori Juridik A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIAL
SEKTORI I VLERËSIMIT DHE PAGESAVE TË NDIHMËS EKONOMIKE DHE
AFTËSISË SË KUFIZUAR

INFORMACION KRAHASUES PËR NDIHMËN EKONOMIKE PËR MUAJIN
JANAR 2025

I. Ndhimja ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin JANAR 2025

Janar	246 familje	fondi	1.144.196
Dhjetor	247 familje	fondi	1.131.373

Për muajin Janar 2025 kemi 1 familje me pak se muaji paraardhës që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi I kushtëzuar.

Fondi i shpenzuar është 12.823 lekë më shumë se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I kushtëzuar janë:

1. Misire Rika (aplikon ne sistem)
2. Marsela Muça (aplikon ne sistem)
3. Natasha Sala (apikon ne sistem)
4. Harikla Kafa (aplikon ne sistem)
5. Alberto Tomorrica (punesim)
6. Gentjan Duka (nuk paraqitet)
7. Sara Vllahi (aplikon ne sistem)
8. Drita Xhafa (rekomanduar 6%)
9. Eda Ndreu (aplikon ne sistem)
10. Imelta Caushi (aplikon ne sistem)
11. Lumnije Manga (aplikon ne sistem)
12. Manjola Prifti (aplikon ne sistem)
13. Marina Balla (aplikon ne sistem)
14. Natasha Puska (aplikon ne sistem)
15. Valentina Jaçe (aplikon ne sistem)
16. Suzana Banushi (aplikon ne sistem)
17. Jonida Karaj (aplikon ne sistem)
18. Hyrije Shengjini (aplikon ne sistem)
19. Vladimir Kanani (aplikon ne sistem)

II. Ndhurma ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin JANAR 2025

Janar	78 familje	fondi	211.600
Dhjetor	75 familje	fondi	202.880

Për muajin Janar 2025 kemi 3 familje më shume se muaji paraardhes që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Bashkisë.

Fondi është 8.720 lekë më shume se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I Bashkisë janë :

1. Nikolin Hazizi (aplikon ne sistem)
2. Xhemile Hasa (aplikon në sistem)
3. Alma Harja (nuk paraqitet)
4. Arif Cace (perfitues ne sistem)
5. Myslim Korra (aplikon ne sistem)
6. Fatmir Qefa (nuk paraqitet)
7. Flamur Kyçyku (nuk paraqitet)
8. Sokol Pisha (aplikon ne sistem)

Përgjegjëse Sektori I vlerësimit dhe pagesave të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar

p/ **Miranda Duka**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 862 Prot

Elbasan më 18/02/2025

RELACION

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin JANAR 2025

KËSHILLIT BASHKIAK

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 11 datë 23.02.2024 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

Propozojmë:

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin JANAR 2025 gjithsej 78 familje me një fond gjithsej 211.600 lekë .
Këto janë familje shumë të varfëra të cilat nuk kanë mundësi të aplikojnë në sistemin e ndihmës ekonomike pasi për shkaqe të ndryshme sociale, shëndetësore dhe ekonomike, një anëtar madhor nuk është prezent gjatë aplikimit .
Këto janë raste të grave të braktisura nga bashkëshortët e tyre dhe anasjelltas, familje të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të shëndetit mendor të cilët largohen nga banesa pa adresë fikse, familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të ndryshme sociale (alkooli, droga etj) të cilët nuk janë në gjendje të paraqiten në ditën e aplikimit të ndihmës ekonomike në sistem.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.

P/ Konceptoi: M.Duka

Konfirmoi: D.Shuli

Zv/Kryetari

Armand Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr _____ Prot

Elbasan më ____/02/ 2025

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ datë ____/02/ 2025

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin JANAR 2025

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/02/2025 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DSHKSK, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 11 datë 23.02.2024 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin janar 2025 për 78 familje me një fond prej 211.600 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr i Shërbimeve Sociale D.Shuli
Drejtori Juridik A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr 861 prot

Elbasan më 18-02 2025

RELACION

Mbi propozimin e kritereve të dhënies së Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar
për bllok-ndihmën ekonomike

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar këshilltarë!

Drejtorja e Shërbimeve Sociale duke u bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” në pikën 1,2,3 të kreut IV të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paraqet për miratim P/Vendimin për kriteret përkatëse.

Bazuar dhe në legjislacionin e sipër cituar familjet që do të trajtohen nga ky fond duhet të jenë nga familjet aplikante në sistemin elektronik të ndihmës ekonomike por që nuk janë shpallur fituese nga formula e pikëzimit.

Përdorimi i këtij fondi është shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm pasi me gjithë përmirësimet e bëra në sistemin elektronik ende ka familje të varfëra të cilat refuzohen nga sistemi për shkak të pikëzimit dhe nuk përfitojnë ndihmë ekonomike.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj për miratim !

P/ Konceptoi: M.Duka
Pranoi: D.Shuli
Konfirmoi: D.Rroseni

Zv.KRYETARI

Armand Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr _____ prot

Elbasan më _____ 2025

PROJEKT - VENDIM
Nr. ___ datë ___/02/2025

**Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar (6 %)
për bllok-ndihmën ekonomike**

KËSHILLIT BASHKIAK

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___/02/2025 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtorja e Shërbimeve Sociale , bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” në pikën 1,2,3 të kreut IV të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”

VENDOSI

- I. Të miratojë kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si më poshtë:
1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit .
 2. Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale që nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit .
 3. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune dhe që nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit .
 4. Familje me shumë fëmijë që nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit .



- II. Dokumentat e aplikuesve të jenë të njëjta me 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”
- III. Masa e ndihmës ekonomike përlllogaritet nga Shërbimi Social Shtetëror sipas VKM nr 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”
- IV. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale si dhe Drejtoria e Financës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Dr. i Shërbimeve Sociale D.Shuli
Drejtori Juridik A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretari Këshillit Bashkiak

Kryetari I Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FASHKIA ELBASAN

Nr. 884 prot

Elbasan me 182 /2025

RELACION

Për vendosjen në institucionet rezidenciale të shërbimeve sociale

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Bazuar në ligjin nr.121/206 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në R.Sh.” dhe VKM nr.518 datë 04.09.2018 “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror”, Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar nëpërmjet punonjësve social të saj të Sektorit të Shtresave në nevojë dhe Moshës së tretë pasi shqyrtoi kërkesat dhe dokumentacionin e paraqitur për vendosje në shërbimin rezidencial për të moshuar në Qendrën Sociale Balashe të bashkisë Elbasan, paraqet për sistemim si më poshte:

1. E moshuara Znj. Fatmire Nasibi Musabelliu, e datëlindjes 15.01.1956, vendbanimi Elbasan, Lagje 28 Nentori, me nr. ID F65115195B propozohet për t’u vendosur në qendrën e përkujdesit social për të moshuar. Znj. Fatmire Nasibi Musabelliu është gjetur në shtete rruge dhe nuk përfiton nga asnjë skemë sociale. Është e divorcuar dhe nuk ka as fëmijë as familjarë te tjerë.
2. I moshuari Z. Fatos Gjysho Avdiaj, i datëlindjes 05.11.1958, vendbanimi Elbasan, Lagje Kongresi Elbasanit, Me nr ID F81105047M propozohet për t’u vendosur në qendrën e përkujdesit social për të moshuar pasi është i vetëm, i divorcuar, pa fëmijë. Prej vitesh ka jetuar në shtëpinë e motrës së tij dhe aktualisht ajo nuk është më në gjendje të kujdeset për të për shkak të moshës së saj dhe angazhimeve familjare për të shkuar jashtë shtetit ku duhet të kujdeset për fëmijët e vajzës së saj.

Në këto kushte të ndodhura Znj. Fatmire Nasibi Musabelliu dhe Z. Fatos Gjysho Avdiaj plotësojnë kriteret për tu akomoduar në azil.

Ky vendim i dërgohet Këshillit Bashkiak për vlerësim përfundimtar, bazuar në nenin 28 të ligjit 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë.

Duke ju falenderuar !

Konceptoi: Spec. Anduena Coku
Pranoi: Pergj. Lindita Senia
Miratoi: Dr. Eltiona Kolla
Drejtor i Pergjithshëm: Dorina Kroseni

ME URDHËR E POROSI

Zv Kryetari Armand Shehu



KRYETARI

Gledian Llatja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ prot

Elbasan më / /2025

PROJEKT-VENDIM

Nr ____/datë / /2025

Për vendosjen në institucionet rezidenciale të shërbimeve sociale

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës / /2025 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar, bazuar në ligjin nr.121/206 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në R.Sh.”, neni 28 dhe VKM nr.518 datë 04.09.2018 “Për përcaktimin e kritereve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror”,

VENDOSI

Të miratojë vendosjen në Qendrën Sociale Balashe, në shërbimin rezidencial si më poshtë:

- I. E moshuara Znj. Fatmire Nasibi Musabelliu, e datëlindjes 15.01.1956, vendbanimi Elbasan, Lagje 28 Nentori, me nr. ID F65115195B.
- II. I moshuari Fatos Gjysho Avdiaj, i datëlindjes 05.11.1958, vendbanimi Elbasan, Lagje Kongresi Elbasanit, me nr ID F81105047M
- III. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes sociale si dhe Qendra Sociale per moshen e trete dhe PAK.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Drejtori i Përgjithshëm

D. Roseni

Drejtori Juridik

A.Hoxha

Drejtori Buxhet-Finance

A.Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr 1096 prot

Elbasan me 26.02 2025

RELACION

Për Propozimin e rikonceptimit të Këshillit Vendor për Sigurinë Publike bazuar udhezimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave, me nr 678, datë 30.10.2024,

KËSHILLIT BASHKIAK

Elbasan

Bazuar në nenin 29 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 11/3 pika d dhe 78/2 i ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", udhezimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.678, datë 30.10.2024, e duke u mbështetur në bashkëpunimin e ngushtë me Institucionin e Prefekturës të Qarkut Elbasan; drejtuar me shkresë zyrtare pranë institucionit tonë më datë 14/11/2024 ,me numer 1256 prot;

Ju informojmë

Se është e nevojshme rikonceptimi i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, si strukturë këshilluese pranë bashkisë, me qëllimin kryesor që të zhvillojë ndërgjegjësimin lidhur me natyrën e krimit, parregullsitë, identifikimin e sjelljeve devijante të grupeve të caktuara, të dhunshme në bashkësinë apo komunitetin ku jetojmë.

Ky mekanizëm do të shërbejë si për identifikimin e problematikave lidhur me sigurinë e shoqërisë, ashtu edhe për adresimin e tyre në institucionet përgjegjëse, të cilët nga ana e tyre do marri masat e tyre parandaluese. Ky bashkëveprim bën të mundur analizimin dhe trajtimin e shkaqeve rrënjësore të akteve të dhunës, duke gjetur zgjidhje efektive dhe në kohë sa më të shpejtë. Krijimi i një bashkëpunimi të qëndrueshëm me të gjitha organet shtetërore ose jo, të cilat operojnë në territorin e bashkisë përmes ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta do të jetë një hap i rëndësishëm për zgjidhjen e problemeve të sigurisë.

Për të parandaluar me sukses përhapjen e veprimeve apo mosveprimeve të dhunshme, duhen bërë përpjekje të lokalizuara, përfshi fuqizimin e mëtejshëm të të rinjve, familjes, grave dhe pakicave. Duke pasur ky këshill sigurie si synim përfundimtar, krijimin e një mjedisi të sigurt në nivel vendor dhe për të gjitha arsyet e trajtuara më sipër:

Propozojmë

1. Rikonceptimin e Këshillit Vendor për Siguri Publike, si një organ konsultues pranë Bashkisë Elbasan.

2. Miratimin e rregullores së tij "Për përbërjen, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyrën e funksionimit të Këshillit Vendor për Siguri Publike".

Vendimet e marra në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike do të dërgohen pranë prefektit të qarkut, brenda 3 (tri) ditëve pune nga marrja e tyre.

Faleminderit për bashkëpunimin!

Konceptoi: S.P.D D.Qelemeni

P.D.P.D K.Kreka

Pranoi: D.D.I.E.P.D E.Çuni

KRYETARI

Gledian LLATJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN PROJEKTEVE DHE DONATOREVE

Nr. ____ Prot.

Datë ____/____/2025

DRAFT
RREGULLORE

**“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNSKIONIMIN E KËSHILLIT VENDOR PËR
SIGURINË PUBLIKE PRANË BASHKISË ELBASAN”**

Konteksti

Zhvillimi ekonomik dhe social i vendit lidhet ngushtë me forcimin e sigurisë publike, uljen e kriminalitetit, zbatimin e ligjit, eliminimin e dhunës dhe mbrojtjen e grupeve të cënueshme, luftën ndaj ekstremizmit të dhunshëm, luftën ndaj kultivimit dhe përdorimit të lëndëve narkotike, apo përballjen me çdo fenomen tjetër krimi dhe paligjshmërie.

Komunitetet në nivel vendor në zona urbane dhe rurale ndeshen me dinamika nga më të ndryshmet që lidhen me zbatimin e ligjit, integritetin e pronës dhe të individit, apo sfida të karakterit ekonomik, social dhe zhvillimor. Një shoqëri e hapur dhe demokratike gjithmonë do të gjendet nën trysinë e kërcënimeve të vazhdueshme të sigurisë të cilat mund të përballën vetëm përmes një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse të të gjithë shoqërisë, duke siguruar një bashkëjetesë të qetë dhe kohezion social.

Pikërisht kjo qasje shumë-aktoriale vendore do të ishte një mekanizëm efektiv në përballjen jo vetëm me kërcënimet e lartpërmendura por edhe me dukuri të reja, si përballja e flukseve imigratore, riintegrimi në shoqëri i azilkërkuesve dhe refugjatëve që iu largohen konflikteve të armatosura në vendet e tyre të origjinës. Po kështu, shoqëria jonë dhe komunitetet vendore po përballen me sfidat në kuadër të procesit të riintegritimit dhe rehabilitimit të qëndrueshëm të shtetasve shqiptarë që kthehen nga zonat e konfliktit si Siria dhe Iraku.

Tashmë është e gjithëpranuar se këto sfida qëndrojnë dukshëm përtej kapaciteteve aktuale të institucioneve, përfshirë ato të zbatimit të ligjit, për t'u përballur me sukses pa bashkëpunuar dhe ndarë përgjegjësitë në nivel vendor midis tyre dhe me qytetarët.

Që nga viti 2016¹, në Bashkinë e Elbasanit nisi ngritja e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike (KVSP), praktikë e cila u shtri gradualisht në shumë bashki të vendit. Ministria e Brendshme,

¹ Me mbështetjen e prezencës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

Policia e Shtetit dhe organizata të ndryshme të vendit dhe ndërkombëtare janë investuar për të operacionalizuar këtë model që bën bashkë institucionet vendore, shoqërinë civile, biznesin dhe aktorë të tjerë.

Përvoja e deritanishme në bashki të ndryshme të vendit dëshmon se baza rregullatore mbi të cilët mbështetet ngritja, funksionimi, i Këshillave Vendor të Sigurisë Publike është e ndryshme. Këto ndryshime prekin objektivat dhe strukturën organizative, proceset konsultuese dhe vendimmarrëse, nivelin e përfshirjes qytetare, rolin e institucioneve të ndryshme në këtë proces të cilat ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e punës së Këshillave Vendor të Sigurisë Publike.

Përvoja në rreth 20 bashki të vendit, ku është pilotuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) i ashtuquajtur "modeli i trekëndëshit"² për bashkëpunimin institucional Bashki-Polici-Prokurori, ofron gjithë eksperiencën e nevojshme dhe një model inovativ për "një rregullore tip" për ngritjen dhe funksionimin e KVSP. Në thelb të kësaj qasjeje qëndron synimi që çdo institucion publik, por edhe të gjithë aktorët jo-publikë përfshirë qytetarët të ndjejnë pronësinë vendore të të gjithë proceseve në luftën kundër krimit, për një komunitet të qëndrueshëm, për mbrojtjen e grupeve të cënueshme, kohezionit dhe zhvillimit shoqëror.

Kreu I

Dispozita të Përgjithshme

Neni 1

Objekti i rregullores

1. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për organizmin dhe funksionimin të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) pranë Bashkise Elbasan, në realizimin e mbledhjeve dhe veprimtarive të tij, sipas detyrimeve që burojnë nga legjislacioni për vetëqeverisjen vendore në fuqi.
2. KSVP funksionin si organ këshillimor kolegjal për çështje të rendit dhe sigurisë publike për Bashkinë Elbasan.

Neni 2

Qëllimi i rregullores

1. Rregullorja ka si qëllim të sigurojë kuadrin e brendshëm rregullator të nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së KVSP.
 2. Rregullorja synon të sigurojë partneritet të qëndrueshëm ndërmjet institucioneve të përfshira në KVSP, bashkëpunimin mes tyre dhe komunitetit me qëllimin përfundimtar krijimin e një ambienti të sigurt për komunitetin e Bashkise Elbasan.
-

Neni 3

Baza ligjore

1. Aktet kombëtare janë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 29/1;
- Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021-2026;
- Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm; VKM 678 datë 30.10.2024

2. Aktet ndërkombëtare:

- Deklarata Universale e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

KREU II

Funksionimi I Këshillit Vendor të Sigurisë Publike

Neni 4

Përbërja e KVSP

1. Këshilli Vendor i Sigurisë Publike përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

- a) Kryetari i Bashkisë;
- b) shefi i Komisarariatit të Policisë;
- c) drejtuesi i Policisë Bashkiake;
- ç) përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar;
- d) drejtuesi i emergjencave civile në bashki;
- dh) përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;
- e) përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;
- ë) përfaqësuesi i njësisë vendore të kujdesit shëndetësor;
- f) përfaqësuesi i Agjencisë Rajonale të Mjedisit;
- g) përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
- gj) përfaqësuesi i administratës rajonale të zonave të mbrojtura;
- h) koordinatori vendor për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare;
- i) përfaqësuesi i njësisë për mbrojtjen e fëmijëve;
- j) kryeinspektori i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit;
- k) përfaqësuesi i Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Këshilli Vendor i Sigurisë Publike mund të ftojë në mbledhjet e tij edhe përfaqësues nga

- a) Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- b) Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm;
- c) komunitetet fetare;
- ç) organizatat e shoqërisë civile (organizatat rinore, të grave, të bizneseve, të pakicave kombëtare, të universiteteve, të mediave lokale), të komunitetit, sipas rastit;
- d) Këshilli Vendor i Rinisë;
- dh) Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit;
- e) shoqatat e njësisive të vetëqeverisjes vendore;
- ë) Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut;
- f) shoqatat e mbrojtjes së konsumatorëve.
- g) anetare të Këshillit Bashkiak

Neni 5

Kryetari i KVSP

1. Kryetari bashkisë është kryetari i KVSP.
2. Kryetari ushtron përgjegjësitë si më poshtë:
 - a) Ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike;
 - b) Organizon mbledhjet e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, minimalisht 1 (një) herë në 3 (tre) muaj ose sa herë vlerësohet e nevojshme nga anëtarët e tij;
 - c) Propozon për vendimmarrje në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike detyra dhe masa konkrete, sipas përgjegjësiave institucionale për zbatimin e prioriteteve për çështjet e rendit dhe të sigurisë në komunitet;
 - ç) Harton, konsulton, miraton, ndjek dhe raporton planin vjetor të punës, sipas masave të planit të veprimit të strategjisë ndërsektoriale të sigurisë në komunitet;
 - d) Përfaqëson Këshillin Vendor të Sigurisë Publike në marrëdhëniet me të tretët, duke përfshirë bashkëpunimet me organizmat ndërkombëtarë dhe ata vendas;
 - dh) Fton në mbledhjet e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike përfaqësuesit e institucioneve, sipas pikës 4, të këtij vendimi;
 - e) Zhvillon forume të hapura konsultative me qytetarët për identifikimin dhe evidentimin e problematikave, lidhur me sigurinë në komunitet.
 - d) informon Këshillin Bashkiak për aktivitetin e KVSP së paku një herë në vit.
3. Në mungesë të kryetarit të KVSP ai përfaqësohet nga zëvendëskryetari i cili është Shefi I Komisarariatit të Policisë.

Neni 6

Përgjegjësitë e KVSP

- a) Angazhohet për parandalimin, minimizimin e rreziqeve dhe kërcënimeve në çështjet që cenojnë sigurinë në komunitet;
- b) Mbikëqyr dhe zbaton planin vjetor të punës, sipas masave të planit të veprimit të strategjisë ndërsektoriale të sigurisë në komunitet;
- c) Identifikon, analizon dhe vlerëson problematikat lidhur me sigurinë në komunitet dhe i trajton ato në mbledhjet e këshillit;
- ç) Propozon zgjidhje për problematikat e rasteve konkrete tek autoritetet kompetente shtetërore, pjesëmarrëse ose jo në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike;
- d) Identifikon prioritetet në fushën e sigurisë në komunitet dhe rekomandon përfshirjen e tyre në mbledhjen e radhës;
- dh) Propozon dhe vlerëson detajet e veprimtarisë së institucioneve përgjegjësie për sigurinë publike në komunitet dhe ia komunikon ato drejtuesve të tyre;
- e) Kontribuon dhe siguron pjesëmarrje në aktivitete ndërgjegjësuese për komunitetin edhe përmes projekteve për çështjet e sigurisë në komunitet;
- ë) Vendos me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij;
- f) Merr në shqyrtim përmbushjen e rekomandimeve për çështjet e trajtuara në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike;
- g) Përcakton përbërjen e sekretariatit teknik.

Neni 7

Metodologjia e hartimit dhe zbatimit të planit vjetor shumë-aktorial vendor

1. Plani vjetor shumë-aktorial për parandalimin dhe luftën ndaj krimit ka për qëllim angazhimin e qëndrueshëm të Bashkisë, Policisë dhe Prokurorisë, si edhe institucioneve të tjera publike dhe private për të zvogëluar intensitetin apo eliminimin e plotë të dukurive që kërcënojnë komunitetin apo grupet vulnerabël. Institucionet e përmendura marrin përsipër angazhime konkrete në ndarjen e përgjegjësive në përballjen me sfidat vendore të sigurisë.
2. Axhenda e planit shumë-aktorial vendor buron nga sfidat dhe kërcënimet e sigurisë të komuniteteve vendore nga takimet konsultuese publike të KVSP me përfaqësues të ndryshëm të komuniteteve vendore (drejtuesit e shkollave të ndryshme, prindërve, qeveritë e nxënësve, kryetarët e fshatrave apo ndërlidhësit komunitarë, përfaqësues të bizneseve vendore, shoqërisë civile dhe medias).
3. KVSP mbështetur në problematikat e diskutuara në takimet konsultuese, harton një plan vjetor veprimi. Ky plan rendit problemet për kriminalitetin të analizuara në bazë prioritizimi (nga ato prioritare të cilat duhet të mbuloohen nga masa imediate, të moderuara e deri te risqet e ulëta të cilat nuk mund të kenë nevojë për masa).
4. Plani vjetor shumë-aktorial i veprimit parashikon një tërësi masash dhe aktiviteteve me institucione përgjegjëse dhe afate konkrete për realizimin e tyre.
5. Monitorimi dhe përditësimi i planit vjetor shumë-aktorial realizohet nga KVSP nëpërmjet takimeve konsultuese të hapura me komunitetin çdo 6 muaj. Ato kanë për qëllim analizën e ecurisë së zbatimit të planit dhe nevojat për përditësimin e tij me objektiva apo masa të reja.

Neni 8

Sekretariati teknik i KVSP

3. Pranë KVSP funksionon sekretariati Teknik i caktuar nga KVSP.
4. Sekretariati Teknik ushtron këto detyra
 - b) Përgjigjet për mbarëvajtjen e veprimtarisë së këshillit vendor nga ana logjistike dhe administrative;
 - b) Mban, ruan dhe përditëson të gjitha kontaktet e anëtarëve të këshillit;
 - c) Organizon dhe bën koordinimin e mbledhjeve të këshillit;
 - ç) Njofton anëtarët për mbledhjen e radhës;
 - d) Përgatit materialet përkatëse paraprake të mbledhjes, sipas rendit të ditës për anëtarët;
 - dh) Merr pjesë në mbledhjet e këshillit, duke mbajtur minutat e takimit;
 - e) Shkëmben informacionin dhe materialet e mbledhjes midis anëtarëve;
 - ë) Harton procesverbalet e mbledhjes dhe raportet;
 - f) Mban listën e pjesëmarrësve të pranishëm në mbledhje;
 - g) Protokollon dhe mban arkivin e procesverbaleve të mbledhjeve;
 - gj) Kontrollon adresën elektronike, si mjet të komunikimit elektronik të këshillit;
 - h) Përgatit dhe bën publikimin e njoftimeve apo materialeve të ndryshme për publikun.

Neni 9

Mbledhjet e KVSP

3. Kryetari i KVSP i thërret dhe i kryeson mbledhjet e KVSP. Ftesa me rendin e ditës dhe materialet për shqyrtim u dërgohen anëtarëve të KVSP së paku 5 ditë pune para mbledhjes së radhës.
4. KVSP zhvillon punën në bazë të rendit të ditës të miratuar nga kryetari i KVSP.

3. Kryetari i KVSP jep fjalën, drejton debatin dhe përcakton fillimin dhe përfundimin e shqyrtimit të secilës çështje të rendit të ditës.
4. Pas mbylljes së diskutimeve mes tyre, anëtarët e KVSP dakordësojnë rekomandime dhe vendime me konsensus të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
5. Mbledhjet e KVSP mbahen së paku 2 herë në vit. Ato zhvillohen në ambientet e bashkisë, me përjashtim të rastit kur Kryetari vendos ndryshe.

Kreu III

Transparenca dhe komunikimi me publikun

Neni 10

Komunikimi me publikun

1. KVSP komunikon me publikun pas çdo mbledhjeje përmes një komunikate për mediat, e cila, sipas natyrës së çështjeve të trajtuara, informon së paku për: a) kohën e mbledhjes; b) pjesëmarrjen; c) çështjet e shqyrtuara në rendin e ditës; ç) thelbin e diskutimeve të KVSP.
2. Njoftimi për publikun përgatitet nga sekretari teknik në bashkëpunim me sekretariatit koordinues të KVSP.
3. Kryetari i KVSP urdhëron publikimin e njoftimit brenda 72 orëve nga zhvillimi i mbledhjes.

KREU IV

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 11

Dispozitë kalimtare

Ndryshimet dhe shtesat në këtë rregullore do të bëhen sipas procedurës së nxjerrjes së saj.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi me miratimin nga mbledhja e Këshillit Bashkiak dhe publikohet në faqen zyrtare të bashkisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN PROJEKTEVE DHE DONATOREVE

Nr _____ prot

Elbasan me . ____ . 2025

KËSHILLIT BASHKIAK
ELBASAN

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____, datë __/__/2025

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës __/__/2025, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Kryetari dhe administrata e Bashkisë, të rikonstruktimit të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike Elbasan

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të ristrukturimit të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike Elbasan.
2. Ngarkohen për zbatim Kryetari i Bashkisë Elbasan sëbashku me strukturat përkatëse.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshill Bashkiak

Konceptoi: P.S.P. D.K.Kreka

Pranoi: D.I.E.P.D. E.Çuni

D.B.F.A. Merkja

D.D.J.A. Hoxha

Miratoi: Nënkryetare A.Bylykbashi

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Lutfi LALA